



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KRYETARI

Nr. 4850 prot

Roskovec, më 07.2024

**SHPLLJE PËR VENDE TË LIRA PUNE
PUNONJËS NË POLICINË E BASHKISË ROSKOVEC**

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar; Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë; të Ligjit nr.89/2022, datë 22.12.2022 “Për Policinë Bashkiake”; VKM-së nr.452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës së Bashkisë Roskovec si dhe Njësive Administrative në varësi Kuman, Strum, Kurjan”; Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 108, datë 21.12.2023 “Për miratimin e nivelit të pagave të punonjësve të Bashkisë Roskovec dhe të Ndërmarrjeve vartëse për vitin 2024”, si dhe të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 109, datë 21.12.2023 “Për miratimin e buxhetit, numrit maksimal të punonjësve të Bashkisë dhe të Ndërmarrjeve vartëse të bashkisë për vitin 2024”, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë Nr. 1298/1 prot. datë 04.01.2024, protokolluar në institucionin tonë me Nr. 54, datë 04.01.2024; Vendimit të Kryetarit të Bashkisë Roskovec Nr. 2, Datë 05.01.2024 “Për miratimin e strukturës organizative dhe pagat përkatëse për Bashkinë Roskovec dhe Njësitë Administrative Kuman, Kurjan dhe Strum, si dhe organigramës për vitin 2024”; si dhe shkresës Nr. 1092, datë 21.02.2024 të Drejtorisë së Policisë Bashkiake, Bashkia Roskovec shpall procedurat e konkurimit për vendet e lira:

Polic në Policinë e Bashkisë Roskovec 2 policë

Përshkrimi i përgjithshëm i punës:

1.Në fushën e rendit dhe sigurisë në komunitet, Policia Bashkiake:

a) merr masa të sigurisë për zbatimin e planit të emergjencës së bashkisë për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme natyrore, si dhe bashkëpunon me strukturat e mbrojtjes civile pranë bashkisë dhe prefektit të qarkut për kapërcimin e tyre;

b) kontrollon zbatimin e rregullave të qarkullimit rrugor në territorin e juridiksionit të saj, sipas parashikimeve në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve të

bashkëpunimit që lidhen me Policinë e Shtetit;

c) vendos kufizimin e qarkullimit në rrugë jashtë qendrave të banuara për ditët e festave lokale në bashkëpunim me organet e Policisë Rrugore;

ç) bashkëpunon me Policinë e Shtetit për mbikëqyrjen e sigurisë brenda territorit të juridiksionit të saj;

d) bashkërendon masat me Policinë e Shtetit për ruajtjen e rendit e të qetësisë publike në raste të aktiviteteve në territorin e juridiksionit të bashkisë;

dh) verifikon zbatimin e ligjshmërisë dhe patrullimin periodik në bashkëpunim me Policinë e Shtetit përgjatë vijës bregdetare publike dhe në zonat çlodhëse të ujërave të brendshme në thellësi të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë; të territorit, për sigurinë në det, plazhe dhe në ujërat e brendshme në thellësi të territorit të juridiksionit të bashkisë;

e) monitoron respektimin e ndarjes së hapësirës së plazhit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të çdo personi juridik apo fizik pranë stacioneve të plazhit në territorin e juridiksionit të bashkisë;

ë) merr masa sigurie në veprimtaritë sportive dhe ndeshjet e futbollit gjatë organizimit dhe zhvillimit të tyre si personel sigurie;

f) mbështet strukturat përgjegjëse të bashkisë për strehimin social, për procedurat e zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre;

g) merr masa për ruajtjen e objekteve në pronësi të bashkisë, si dhe të atyre që administrohen nga ana e saj.

Kandidatët për policë duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

a) të jetë shtetas shqiptar;

b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

c) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;

ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm të lartë;

d) të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundërvajtjeje penale;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

e) të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislati në fuqi për punonjësit e Policisë së Shtetit;

ë) të paraqesë vërtetimin e besueshmërisë.

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a) kërkesën;
- b) jetëshkrimin;
- c) fotokopjen e kartës së identitetit;
- ç) fotokopjet e noterizuara të diplomës të arsimit të mesëm të lartë;
- d) 2 (dy) foto me përmasa 4 x 6 cm;
- dh) raportin mjekoligjor mbi gjendjen shëndetësore;
- e) certifikatën e gjendjes gjyqësore (dëshmi penaliteti);
- f) vërtetimin nga prokuroria për qenien ose jo në ndjekje penale;
- g) vërtetimin nga gjykata për çështje në proces gjykimi;
- h) dokumentet për vërtetimin e përvojës në punë apo librezën e punës;
- i) vlerësimin e fundit të punës, kur aplikantët vijnë nga administrata publike;
- j) vërtetimin që të mos ketë masë disiplinore të largimit nga puna që nuk është shuar ose të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- k) vërtetimin që të mos jetë larguar nga Policia e Shtetit dhe Garda e Republikës, për shkak të vlerësimeve kalimtare ose periodike, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo në sportelet e Sektorit të Zyrës me Një Ndalesë (One Stop Shop) në Bashkinë Roskovec brenda datës 30.07.2024.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK TË DOKUMENTACIONIT

Pas verifikimit të dokumentacionit, në respektim të afatit ligjor, Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Roskovec do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec, në standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet testimi. Kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail) për shkaqet e moskualifikimit. Kandidatët e skualifikuar kanë të drejtë të ankimohen pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Bashkisë Roskovec. Afati i ankimit është **5 ditë** nga data e shpalljes së rezultateve të verifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me njohuritë mbi:

- a- ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”
- b- ligjin nr.89/2022, datë 15.5.1997 “Për Policinë Bashkiake”
- c- VKM nr.452 datë 26.07.2023 “Për miratimin e rregullores kuadër të Policisë Bashkiake”

- d- VKM nr. 494, datë 24.08.2023 "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të policisë bashkiake"
- e- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë.
- f- ligjin nr.9131/08.06.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Testimi me shkrim

Kandidatët në testimin me shkrim do të vlerësohen në lidhje me:

a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me punën;

Kandidatët që marrin 60% (24 pikë) të pikëve të testimit me shkrim, kanë të drejtë të vazhdojnë fazën e Testimit fizik

Testimi fizik

Testimit fizik u nënshtrohen të gjithë kandidatët që kanë kaluar me sukses testimin me shkrim për pranim në Policinë Bashkiake. Do të testohen aftësitë psikomotore të kandidatit, ku përfshihen shpejtësia, shkathtësia fizike, rezistenca dhe koordinimi fizik.

Kandidati që merr mbi 60% të pikëve (12 pikë) të përcaktuara për testimin e aftësive fizike vazhdon konkurrimin.

Intervista

Kandidatët, që rezultojnë fitues në fazat e tjera të testeve, i nënshtrohen intervistës.

Kandidatët në intervistën me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Në Intervistë, totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është 20 (njëzet) pikë, të cilat ndahen përkatësisht:

a) jetëshkrimi (CV), që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, deri në 10 pikë;

b) intervista, deri në 10 pikë.

Rezultati i përgjithshëm i kandidatit përcaktohet mbi shumatorën e rezultateve të arritura nga testimi me shkrim, testimi fizik dhe intervista.

Totali i pikëve për vlerësimi e kandidatëve është 100 pikë i detajuar si më poshtë:

Vlerësimi maksimal për testimin me shkrim është	60 pikë
Vlerësimi maksimal për testimin e aftësive fizike është	20 pikë
Vlerësimi maksimal për intervistën me gojë është	20 pikë

Kandidatët që marrin mbi 60 pikë janë kandidatët fitues.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, për çdo fazë (testimit me shkrim, testimit fizik dhe intervistës me gojë) Njësia e Burimeve Njerëzore në Bashkinë Roskovec do të shpallë fituesit në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen e internetit të Bashkisë Roskovec dhe në standat e informimit të publikut.

Kandidati ka të drejtë të bëjë ankim me shkrim në Komisionin Përzgjedhës për rezultatin e pikëve dhe renditjen në listën fituese. Afati i ankimit fillon brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga:

- a) data e njoftimit të rezultatit të verifikimit paraprak të kandidatit;
- b) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimit me shkrim;
- c) data e njoftimit të rezultatit të testimit të aftësive fizike;
- ç) data e njoftimit të rezultatit të vlerësimeve për kandidatët, të cilët kanë marrë pjesë në të gjitha fazat e vlerësimit të përcaktuara.

Komisioni përzgjedhës njofton vendimin brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e përfundimit të afatit ankimor.

Në përfundim të këtij afati, njësia e burimeve njerëzore publikon listën përfundimtare fituese.

KRYETAR
Majlinda Bufi

